



## Shërbimi për Publikun nga Zyrat e Shërbimit të Azilit nga 18.05.2020-29.05.2020

Duke filluar nga dita e Hënë 18.05.2020, Shërbimi i Azilit i Ministrisë së Emigracionit dhe Azilit do të presi sërish publik. Ndërkohë, duke pasur për qëllim mbrojtjen e shëndetit publik dhe përkufizimin e shpërndarjes së COVID-19, dëshirojmë të informojmë publikun për sa vijon.

1. Vlefshmëria e kartave të aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare, të cilat kanë skaduar ose skadojnë nga data 13.03.2020 (dita e fillimit të shtytjes së shërbimit për publikun) deri më 31.05.2020 shtyhet me vendim të ri të ministrisë për një **periudhë gjashtë (6) mujore**. Për rrjedhojë, Shërbimi i Azilit **nuk do të kryej procedurën e rinovimit të kartave** të aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare për periudhën kohore deri më 31.05.2020. Përfshihen nga sa përmëndëm më sipër: Zyrat Rajonale të Azilit të Lesbos, Samos, Hios, Leros dhe Degës së Pavarur të Kos, të cilat do të kryejnë rinovimin e kartave të përfituesve.
2. Nga dita e Hënë 18.05.2020, do të depozitohen në mënyrë elektronike kërkesat për ndryshimin e të dhënave të komunikimit, ndryshimit të të dhënave bazë, ndarje dosjesh, nxjerrje fotokopje të dosjes, vërtetim i ecurisë së kërkesës, e shtytjes/përsheptimit të intervistës, ndihmës juridike, si dhe kërkesë për depozitim dokumentash. Modele përkatëse do të publikohen në faqet elektronike të Shërbimit, të cilat do të dërgohen në mënyrë elektronike në adresat elektronike të zyrave vendore përkatëse.
3. Nga dita e Hënë 18.05.2020 do të zhvillohen normalisht depozitimet e apelimeve.